



**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti: Fakulteti i shkencave matematike - natyrore

Lëndët/Pozitat:

1. Pozita 1. Grup lëndësh nga kimia analitike

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtarëve):

- 1. Kryetar Prof. Naser Troni**
- 2. Anëtar Prof.asoc. Skender Demaku**
- 3. Anëtar Prof. asst. Jeton Halili**

Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave apo kandidatëve):

Pozita/lëndët: 1. Grup lëndësh nga kimia analitike

- 1. Arbër Musliu (Nr. 000011)**
- 2. Ariana Aliu (Nr. 000012)**
- 3. Vjosa Grapci (Nr. 000013)**

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).

Në bazë të Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, Datë: 17/07/2024, Komisioni vlerësues ka shqyrtuar dosjet e tre kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm (Pozita 1) për mbajtjen e ushtrimeve laboratorike për grup lëndësh nga kimia analitike. Kandidatët janë vlerësuar në bazë të kriterëve të paraqitura në këtë rregullore. Pas një analize të hollësishme, komisioni vlerësues ka hartuar raportin e mëposhtëm për secilin kandidat.

I. Përgatitja akademike

1. Arbër Musliu ka diplomuar në nivelin bachelor në vitin 2017 në FSHMN-Kimi në Universitetin e Prishtinës, me notë mesatare prej 8.59. Në vitin 2020 ka përfunduar studimet master në Kimi Analitike dhe Mjedisit, me notë mesatare prej 9.0, duke treguar rezultate të larta në të dy nivelet e studimit.
2. Ariana Aliu ka përfunduar studimet bachelor në vitin 2019 në FSHMN- Kimi Inxhinierike në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare prej 8.0 dhe në vitin 2023 ka përfunduar studimet master në programin Kimi Analitike dhe Mjedisit me notë mesatare prej 8.82.
3. Vjosa Grapci ka diplomuar në vitin 2021 në FSHMN-Kimi Inxhinierike me notë mesatare prej 8.5 dhe ka përfunduar studimet master në programin Kimi Analitike dhe Mjedisit vitin 2023 me një notë mesatare prej 8.88.

II. Numri i publikimeve shkencore

1. Arbër Musliu ka botuar tre punime shkencore në revista të njohura. Një punim i tij është botuar në *Electroanalysis*, ndërsa dy të tjerët në *International Journal of Applied Physics* dhe *EPE*, duke demonstruar angazhim në fushën e kërkimit shkencor dhe lidhje direkte me tematikën e kimitë analitike.
2. Ariana Aliu ka një publikim shkencor në *Electroanalysis*, i cili trajton zhvillimin e një sensori elektrokimik, që është relevant për fushën e kimitë analitike.



3. Vjosa Grapci ka një publikim në revistën Agriculture and Forestry, i cili fokusohet në analizën e përmbajtjes minerale të frutave, një fushë e ngushtë brenda kimisë analitike.

II. Përvoja profesionale

1. Arbër ka përvojë si asistent i angazhuar në Fakultetin e Mjekësisë dhe Universitetin e Mitrovicës, ku ka mbajtur ushtrime në lëndët e Kimisë Mjekësore, Kimisë së Përgjithshme dhe Kimisë Inorganike. Kandidati po ashtu është student i doktoratës në në Universitetin e Prishtinës, FSHMN – Departamenti i Kimisë.
2. Ariana Aliu ka përvojë si praktikante në Ministrinë e Industrisë dhe më parë ka punuar si laborante në një kompani, por nuk ka përvojë të dokumentuar në mësimdhënie.
3. Vjosa Grapci është aktualisht bashkëpunëtorë e jashtme në lëndën e Kimisë Mjekësore në Fakultetin e Mjekësisë dhe ka kryer disa praktika profesionale, përfshirë laboratorin e analizave të ujit dhe ajrit.

Përfundimi

Bazuar në krahasimin e përgatitjes akademike, notës mesatare të studimeve Bsc dhe Msc, publikimeve shkencore, përvojës profesionale, të tre kandidatët i plotësojnë kriteret minimale sipas Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 21/254, Datë: 17/07/2024.

Në krahasim me dy kandidatët e tjerë, Arbër Musliu del si kandidati më i kualifikuar për pozitën 1 (Grup lëndësh nga kimia analitike). Ai përmbush kriteret e rregullores dhe ka përparësi ndaj kandidatëve të tjerë për të gjitha aspektet kryesore të vlerësimit. Prandaj, duke u bazuar në faktografitë e lartshënuara, komisioni vlerësues propozon që kandidati Arbër Musliu të zgjedhet si bashkëpunëtor i jashtëm për pozitën Nr. 1 (Grup lëndësh nga kimia analitike)

Komisioni vlerësues

1. Kryetar Prof Dr. Naser Troni
2. Anëtar Prof.asoc. Dr. Skender Demaku
3. Anëtar Prof. asst. Dr. Jeton Halili

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"			
FAKULTETI I SHKENCËVE MATEMATIKE-NATYRORE			
PRISHTINË			
Punuar më	11/10/2024		
Nr. orig	Numer	Sasia	Vlera
01	4562	4	-